



Realiteti

20%

hendeku i madh gjinor në lidhjen e kontratave publike

Hyrje

Prokurimi publik, konkretisht kontratat publike, paraqesin një nga mekanizmat më të rëndësishëm për shpenzimin e parasë publike, përmes të cilit institucionet kontraktojnë punë, mallra dhe shërbime.

Kontratat publike janë shumë të rëndësishme për një numër të madh të bizneseve, pasi që ato sigurojnë një rrjedhë të qëndrueshme dhe të sigurt të të ardhurave, duke u garantuar bizneseve një stabilitet financiar. Në Kosovë, gjatë vitit 2023, institucionet publike lidhën 10,183 kontrata, në vlerë totale prej 810,438,403.40€, që paraqet 8.23% të Bruto Produktit Vendor (BPV)¹.

Nëse krahasojmë ndarjen e këtyre kontratave se sa prej tyre fitohen nga bizneset që janë në pronësi të burrave e sa në pronësi të grave, atëherë del se shpërndarja e tyre është shumë jo proporcionale. Sipas të dhënave nga Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës (ARBK), në vitin 2023 në Kosovë ishin 96,995 biznese aktive, ku 76,335 (78.7%) ishin në pronësi të burrave, 17,459 (18%) në pronësi të grave, 2231 (2.3%) në bashkëpronësi të të paktën një gruaje, ndërkohë për 970 (1%) tjera nuk dihej gjinia e pronarit². Përveç faktit që bizneset në pronësi të grave janë shumë më të rralla se bizneset në pronësi të burrave, ekziston edhe një perceptim që një numër i madh i bizneseve që zyrtarisht janë në pronësi të grave, në praktikë udhëhiqen nga burrat, ndonëse ky punim nuk e trajton këtë problematikë³.

1 Raporti mbi aktivitetin e prokurimit publik në Kosovë për vitin 2023. KRPP. Gjetet në <https://e-prokurimi.rksgov.net/HOME/Documents/Legislation/Raportet%20Vjetore/shq/Raporti%20Vjetor%202023.pdf>

2 Ndërmarrësia e grave dhe pakicave etnike në Kosovë. Instituti GAP. 2023. Gjetet në: https://www.institutigap.org/documents/9049_Nd%C3%ABrmarr%C3%ABsia%20e%20grave%20dhe%20Pakicave%20etnike.pdf

3 Bizneset e grave që i udhëheqin burrat. Radio Evropa e Lirë. 2023. Gjetet në: <https://top-channel.tv/2023/11/06/kosove-bizneset-e-grave-qe-i-udheheqin-burrat/>

Ky hulumtim analizon pjesëmarrjen e bizneseve në pronësi të grave në kontrata publike gjatë vitit 2023, duke nxjerrë në pah dallimin mes numrit të bizneseve me pronare gra në ekonomi dhe pjesëmarrjes së tyre në prokurim publik.

Nga 1,424 kontrata publike të lidhura gjatë 2023 nga shtatë komunat më të mëdha në Kosovë, të cilat ishin mostër e hulumtimit, bizneset në pronësi të grave fituan vetëm 104 kontrata. Edhe pse bizneset në pronësi të grave përbëjnë 18% të të gjitha bizneseve në vend, këto biznese fituan vetëm 7.3% e kontratave publike.

Pabarazia është edhe më e theksuar kur merret parasysh vlera totale e këtyre kontratave. Bizneset në pronësi të grave, morën vetëm 2% apo 3,778,108.07€ nga gjithsej 183,751,573,83€ sa ishte vlera totale e kontratave të dhëna. Ky kontrast i fortë nënvizon sfidat e rëndësishme me të cilat përballen bizneset në pronësi të grave në lidhjen e kontratave publike, pavarësisht pranisë së tyre të dukshme në peizazhin më të gjerë të biznesit.

Në Kosovë, Ligji për Barazi Gjinore parasheh masa të veçanta dhe të përkohshme me qëllim të përshejtitimit të realizimit të barazisë faktike midis grave dhe burrave në fushat ku ekzistojnë pabarazi, duke përfshirë kuota për të arritur përfaqësim të barabartë, programe për të rritur dhe ndihmuar pjesëmarrjen e gjinisë më pak të përfaqësuar dhe fuqizim ekonomik për të përmirësuar pozitën e grave në shpërndarjen e burimeve përmes trajtimit preferencial⁴. Ky ligj në mënyrë eksplicite kërkon që parimet e barazisë gjinore të respektohen në të gjitha proceset financiare dhe buxhetore. Proceset e prokurimit publik gjithashtu duhet t'u përmbahen këtyre parimeve, duke siguruar që politikat dhe praktikatat e prokurimit të promovojnë mundësi të barabarta për gratë dhe burrat. Në praktikë, kjo do të thotë që kur ndahen fondet publike, ato duhet të menaxhohen në një mënyrë që aktivisht çon drejt arritjes së barazisë faktike gjinore, duke siguruar qasje dhe përfitime të drejtë për gratë dhe burrat.

Ndërkohë, Ligji i Prokurimit Publik (LPP) në Kosovë përmes të cilit lidhen të gjitha kontratat publike, nuk ka asnjë lloj të përkufizimit të “biznesit në pronësi të grave”, teksa çështja e barazisë gjinore përmendet vetëm në një nen⁵, i cili ju mundëson autoriteteve kontraktuese që të vendosin kushte specifike apo detyrime gjatë ekzekutimit të kontratës, që janë projektuar për të nxitur barazinë gjinore, apo diversitetin mbi baza të tjera.

Megjithatë, as LPP, dhe as legjislacioni përcjellës, nuk sqarojnë dhe definojnë se për çfarë specifikime dhe detyrime bëhet fjalë, ndaj në praktikë nuk ka asnjë lloj mase afirmative të evidentuar për bizneset në pronësi të grave.

⁴ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.05/L-020 për Barazi Gjinore. Neni 6. Gjetendet në: <https://gzk.rks-gov.net/Act-Detail.aspx?ActID=10923>

⁵ Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. Ligji nr.04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës. Neni 31, pika 2.4. Gjetendet në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>

Metodologjia

Bazë për këtë hulumtim janë kontratat e dhëna përmes prokurimit publik gjatë vitit 2023, nga shtatë komuna më të mëdha në Kosovë: Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Mitrovicë, Ferizaj, Gjiilan. Këto komuna, në cilësinë e autoriteteve kontraktuese nënshkruan 1424 kontrata publike në vlerë prej 183,751,573.37 euro, më shumë se gjysma (50.65%) e kontratave publike të dhëna nga të gjitha komnat e Kosovës gjatë vitit 2023⁶.

Të dhënat e kontratave janë marrë nga sistemi elektronik e-prokurimi⁷ dhe raporti vjetor i prokurimit publik për vitin 2023, ndërkohë të dhënat e bizneseve janë marrë në ARBK. Pronësia e bizneseve është evidentuar në ARBK, ku për bazë është marrë gjinia e pronarëve të cilët kanë mbi 50% të aksioneve në biznes.

Kontratat për bizneset me pronësi të përzier janë marrë kontratat që janë fituar nga bizneset që kanë disa pronarë, ku të paktën është një grua që i zotëron 50% të aksioneve, si dhe kontratat që janë fituar nga dy apo më shumë biznese, ku të paktën një nga bizneset është në pronësi të grave.

Pjesëmarrja e bizneseve me pronësi të grave në kontrata publike

Ashtu si numri dhe pjesëmarrja e grave në biznese është relativisht e ulët, bizneset në pronësi të grave janë edhe më pak të përfaqësuara në lidhjen e kontratave publike me institucionet publike.

Bizneset në pronësi të grave shpesh hasin sfida në sigurimin e kapitalit dhe kapaciteteve njerëzore⁸, përfaqësim të ulët në shumë sektorë fitimprurës dhe jetëgjatësisë më të ulët në raport me bizneset me pronarë burra⁹.

Bizneset në pronësi të grave mund të mos jenë plotësisht të informuara në lidhje me procedurat e tenderëve publik, për shkak numrit të vogël të punëtorëve me të cilin operojnë dhe mungesës së stafit të kualifikuar që do të kujdesej për ofertimin në prokurim publik. Mbi 98% e bizneseve në pronësi të grave në Kosovë kanë nëntë (9), ose më pak të punësuar¹⁰.

Përveç në fazën e para tenderimit, numri i ulët i punëtorëve ndikon në kapacitetet për të marrë dhe realizuar kontrata të mesme apo të mëdha dhe kufizon aftësitë e tyre për të konkurruar kundër bizneseve më të mëdha.

6 Raporti mbi aktivitetin e prokurimit publik në Kosovë për vitin 2023. KRPP: <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Raportet%20Vjetore/shq/Raporti%20Vjetor%202023.pdf>

7 Në rastet e kontratave kornizë me çmime për njësi, është marrë vlera e parashikuar e kontratës.

8 Bizneset mikro, të vogla dhe të mesme përbëjnë 99% të nr. të përgjithshëm të bizneseve në pronësi të grave në Kosovë. 2023 . Instituti GAP. https://www.institutigap.org/documents/9049_Nd%C3%ABrmarr%C3%ABsia%20e%20grave%20dhe%20Pakicave%20etnike.pdf

9 Jetëgjatësia mesatare e bizneseve në pronësi të grave është 4.36 vite, ndërkohë mesatarja për bizneset me pronarë burra është 8.1 vjet. Instituti GAP. 2023. https://www.institutigap.org/documents/9049_Nd%C3%ABrmarr%C3%ABsia%20e%20grave%20dhe%20Pakicave%20etnike.pdf

10 Po aty.

Bizneset në pronësi të grave shpesh janë të nënpërfaqësuar në industritë që dominojnë prokurimin publik, si ndërtimi i rrugëve dhe objekteve, furnizimi me karburante, furnizimet me barna. Aktiviteti primar më i zakonshëm në mesin e bizneseve në pronësi të grave është tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuara, ku mbizotërojnë ushqimet, pijet dhe duhani; pastaj nga tregtia me pakicë e tekstileve në dyqane të specializuara dhe aktivitete shërbimesh¹¹.

Bizneset në pronësi të grave morën më së shumti kontrata në Komunën e Gjakovës, ndërkohë më së paku në Komunën e Gjilanit. Pjesëmarrja më e ulët e bizneseve në pronësi të grave në kontrata publike, në raport me numrin e përgjithshëm të kontratave të dhëna ishte në Komunën e Prizrenit (3.2%), ndërkohë më e larta ishte në Komunën e Gjakovës (15.7%).

Në raport me vlerën e kontratave të dhëna për bizneset në pronësi të grave, Gjakova prin përsëri me 1,225,169.41€ të dhëna gjatë vitit 2023, teksa vlera më e ulët e kontratave të fituara nga bizneset në pronësi të grave ishte në Komunën e Gjilanit me vetëm 82,440.00€. Shprehur në përqindje, pjesëmarrja më e madhe e vlerës së kontratave të dhëna për bizneset në pronësi të grave ishte në Komunën e Gjakovës (5.7%), ndërkohë më e ulëta në Komunën e Gjilanit (0.7%).

TABELA 1. Pjesëmarrja e bizneseve me pronare gra në kontrata publike gjatë vitit 2023

Komuna	Nr. total i kontratave të dhëna	Nr. i kontratave të fituara nga bizneset në pronësi të grave	Vlera totale e kontratave të dhëna (€)	Vlera e kontratave të fituara nga bizneset në pronësi të grave (€)
Prishtinë	295	15 (5%)	47,192,788.63	683,077.99 (1.4%)
Prizren	275	9 (3.2%)	33,642,301.45	317,065.50 (0.9%)
Ferizaj	171	9 (5.2%)	38,016,120.78	388,337.25 (1%)
Pejë	177	13 (7.3%)	16,921,629.03	445,011.52 (2.6%)
Gjilan	135	6 (4.4%)	11,547,032.52	82,440.00 (0.7%)
Gjakovë	197	31 (15.7%)	21,414,319.40	1,225,169.41 (5.7%)
Mitrovicë	200	21 (10.5%)	12,150,999.28	209,114.00 (1.7%)

Kontratat më të mëdha të fituara nga bizneset me pronare gra gjatë vitit 2023, ishin kontratat për sigurimin fizik të objekteve të Komunës së Gjakovës, në vlerë totale 397.563.71€, pasuar nga kontrata për ndërtimin e shtratit të lumit Llukac, në vlerë 387,597.30€. Ndërkohë, 29 kontrata të fituara nga bizneset me pronare gra ishin të vlerës minimale (më pak se 1000€).

¹¹ Po aty.

■ TABELA 2. Pesë kontratat më të mëdha të fituara nga bizneset në pronësi të grave

Komuna	Emri i kontratës	Vlera e kontratës (€)
Gjakovë	Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës	397,563.71
Gjakovë	Ndërtimi i shtratit të Lumit Llukac	387,597.30
Ferizaj	Kryerja e shërbimeve të nevojshme për arritjen e objektivave të tatimit në pronë	250,000.00
Prishtinë	Hartimi i Zgjidhjes urb-arkitektonike e ndërlidhjes së lagjes “Kalabria” me lagjen “Dardania ”	218,429.80
Gjakovë	Furnizim me autocisternë për njësinë e zjarrfikësve	194,499.00

Bizneset në pronësi të përzier, qoftë si aksionar/e brenda një biznesi, apo si konzorciume të disa bizneseve ku njëri biznes kishte pronare një grua, morën më pak kontrata (81), në raport me bizneset që kishin pronare vetëm gra, por vlera e këtyre kontratave ishte shumë më e madhe (16,300,569.12€), se vlera e kontratave të fituara nga bizneset në pronësi të grave (3,778,108.07€).

■ GRAFIKU 1. Krahasimi i vlerës së kontratave të fituara nga bizneset në pronësi të grave dhe bizneset me pronësi të përzier





TABELA 3. Pjesëmarrja e bizneseve me pronësi të përzier (mikse) në kontrata publike gjatë vitit 2023

Komuna	Nr. total i kontratave të dhëna për biznese me pronësi të përzier	Vlera totale e kontratave të dhëna për biznese me pronësi të përzier
Prishtinë	11	2,421,370.85 euro
Prizren	13	1,423,551.44 euro
Ferizaj	17	4,551,530.70 euro
Pejë	13	2,421,370.85 euro
Gjilan	5	1,035,521.00 euro
Gjakovë	8	3,263,649.28 euro
Mitrovicë	14	1,183,575.00 euro

Gati gjysma (50) e të gjitha kontratave të dhëna për bizneset me pronare gra gjatë vitit 2023, ishin kontrata për furnizime, teksa më së paku ka kontrata për punë (16), që zakonisht janë kontrata me vlera të mesme dhe të larta.

■ GRAFIKU 2. Llojet e kontratave të lidhura nga bizneset në pronësi të grave gjatë vitit 2023



PËRFUNDIME:

- Bizneset në pronësi të grave janë shumë të nënpërfaqësuar në lidhjen e kontratave publike, duke fituar vetëm 2% të vlerës totale të kontratave të dhëna nga shtatë (7) komunat më të mëdha të Kosovës gjatë vitit 2023. Edhe pse Buxheti i Përgjegjshëm Gjikor (BPGJ) është një kërkesë ligjore në Kosovë, ai ende nuk është duke u zbatuar në mënyrë efektive në proceset e prokurimit publik.
- Komuna e Gjakovës, ishte komuna që lidhi më së shumti kontrata me bizneset me pronare gra gjatë vitit 2023, duke nënshkruar 31 kontrata me këto biznese në vlerë të përgjithshme 1,225,169.41€.
- Bizneset në pronësi të grave lidhën më së shumti kontrata për furnizime, ndërkohë më së paku kontrata për punë.
- Mbi 30% e të gjitha kontratave të nënshkruara nga bizneset me pronare gra gjatë vitit 2023 me shtatë (7) komunat më të mëdha të Kosovës, ishin kontrata të vlerës minimale nën 1,000€.

REKOMANDIME:

- Ligji i ri për Prokurimin Publik duhet të inkorporojë masa afirmative dhe BPGJ për të rritur pjesëmarrjen e bizneseve në pronësi të grave në prokurimin publik. Kjo përfshin vendosjen e objektivave dhe udhëzimeve të qarta për të siguruar qasje dhe mundësi të barabarta për ndërmarrjet në pronësi të grave në procesin e prokurimit publik. Institucionet publike në cilësinë e autoriteteve kontraktuese, duhet të vendosin kërkesa të veçanta në dosjet e tenderëve, të cilat nxitin barazinë gjinore në përputhje me legjislacionin aktual.
- Në përputhje me Ligjin për Barazi Gjinore, të parashihen programe dhe masa të veçanta si kuota gjinore dhe trajtime preferencial, për të ndihmuar dhe mbështetur rritjen e pjesëmarrjes së grave në prokurim publik.
- Institucionet publike, në veçanti KRPP, duhet të krijojë mekanizma të qëndrueshëm për monitorimin dhe raportimin e përparimit të barazisë gjinore në ndarjen e kontratave publike, duke ofruar të dhëna të rregullta dhe të përditësuara për pjesëmarrjen e grave në këtë fushë.
- Odat dhe asociacionet e bizneseve të organizojnë trajnime të rregullta për gratë pronare të bizneseve, me fokus në rritjen e aftësive për pjesëmarrje në tenderët publikë. Këto trajnime duhet të përfshijnë njohuri mbi procedurat e prokurimit, përgatitjen e ofertave konkurruese, me qëllim të përmirësimit të kapaciteteve të bizneseve të grave për të konkurruar në mënyrë të suksesshme në prokurim publik.